

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6879
E martë, 25 prill 2023
Çmimi 0.40 €

Mavraj ia uron ditëlindjen
Thaçit: Ai ishte kryesori
për krijimin e historisë
së re të Kosovës | FAQE 3



Muhamet Mavraj

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRANOHET APLIKIMI I KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS (KE) | FAQE 4-5

KOSOVA NJË HAP MË PRANË ANËTARËSIMIT NË KËSHILLIN E EVROPËS



Council of Europe Conseil de l'Europe

Republika e Kosovës ka kaluar me sukses fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës (KE). Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare, me mbi dy të tretat e votave të

nevojshme, i ka dhënë mbështetje të hënën aplikimit të Kosovës në KE, duke përmbyllur kështu fazën e parë të anëtarësimit të plotë të shtetit tonë në këtë organizatë të

rëndësishme ndërkombëtare. Me këtë rast, liderët e institucioneve kanë shprehur bindjen se flamuri i Kosovës së shpejti do të valëvitet edhe në Këshillin e Evropës

BOJKOTIMI I ZGJEDHJEVE NGA SERBËT, OSMANI DHE KURTI AKUZOJNË SERBINË PËR SHANTAZH



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



AKIS VAVALIS: DUA TË BËHEM KAMPION
ME DRITËN | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shpenzimet ushtarake botërore arrijnë nivelin më të lartë të të gjitha kohëve

STOKHOLM, 24 PRILL - Shpenzimet ushtarake botërore kanë arritur nivelin më të lartë të të gjitha kohëve prej 2.24 trilionë dollarësh në vitin 2022 pasi agresioni rus mbi Ukrainë ka nxitur një rritje në shpenzimet ushtarake në të gjithë Evropën, sipas një instituti të mbrojtjes.

Shpenzimet globale janë rritur për të tetin vit radhazi, ka thënë të hënën Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve të Paqes në Stokholm (SIPRI) në raportin e tij vjetor mbi shpenzimet ushtarake globale.

Në këtë drejtim bëhet me dije se kishte një rritje prej 13-përqindësh në Evropë, rritja më e madhe në të paktën 30 vjet. SIPRI ka theksuar se shumica e kësaj ishte e lidhur me Rusinë dhe Ukrainën, por vende të tjera, gjithashtu, rritën shpenzimet ushtarake në përgjigje të kërcënimeve të perceptuara ruse. "Rritja e vazhdueshme e shpenzimeve ushtarake globale në vitet e fundit është një shenjë se ne po jetojmë në një botë gjithnjë e më të pasigurt. Shtetet po rritin forcën ushtarake në përgjigje të një mjedisi të përkeqësuar të sigurisë, të cilin

nuk parashikojnë të përmirësohet në të ardhmen e afërt", ka vlerësuar Nan Tian nga Programi i Shpenzimeve Ushtarake dhe Prodhimit të Armëve të SIPRI.

Moska ka filluar agresionin dhe pushtoi gadishullin e Krimesë të Ukrainës në vitin 2014 dhe mbështeti rebelët separatistë në lindje të vendit përpara se ta fillonte pushtimin e saj në shkallë të plotë në shkurt të vitit 2022. Lëvizjet kanë përhapur alarmin midis vendeve të tjera që janë fqinjë me Rusinë ose dikur ishin pjesë e sferës së ndikimit të Bashkimit Sovjetik, me shpenzimet e Finlandës deri në 36 për qind dhe shpenzimet ushtarake të Lituaniës me 27 për qind, sipas SIPRI.

Në prill, Finlanda, kufiri i së cilës me Rusinë shtrihet rreth 1 340 km (833 milje), u bë anëtarja e 31-të e NATO-s. Suedia, e cila i ka shmangur aleancat ushtarake për më shumë se 200 vjet, dëshiron, gjithashtu, të bashkohet me NATO-n.

"Ndërsa pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës në shkurt 2022 sigurisht që ndikoi në vendimet e shpenzimeve ushtarake në vitin



2022, shqetësimet për agresionin rus janë krijuar për shumë më gjatë. Shumë shtete të ish-bllokut lindor kanë dyfishuar shpenzimet e tyre ushtarake që nga viti 2014, vit kur Rusia aneksoi Krimenë", ka thënë Lorenzo Scarazzato, studiues me Programin e Shpenzimeve Ushtarake dhe Prodhimit të Armëve të SIPRI.

Instituti, gjithashtu, ka thënë se shpenzimet ushtarake në Ukrainë janë rritur më shumë se gjashtë herë në 44 miliardë dollarë në vitin 2022, rritja më e lartë njëvjeçare në shpenzimet ushtarake të një vendi të regjistruar ndonjëherë në të dhënat e SIPRI.

Si përqindje e produktit të

brendshëm bruto (PBB), shpenzimet ushtarake janë rritur në 34 për qind më 2022 krahasuar me 3.2 për qind një vit më parë.

Në anën tjetër, shpenzimet ushtarake ruse janë rritur rreth 9.2 për qind në vitin 2022, në rreth 86.4 miliardë dollarë, sipas SIPRI.

Shtetet e Bashkuara mbeten shpenzuesi më i madh ushtarak në botë – deri në 0.7 për qind në 877 miliardë dollarë në vitin 2022 – që ishte 39 për qind e totalit të shpenzimeve ushtarake globale.

Rritja është nxitur kryesisht nga "niveli i paprecedentë i ndihmës financiare ushtarake që i ofroi Ukrainës", ka thënë Nan Tian. Ndihma financiare ushtarake amerikane për Ukrainën ka arritur në 19.9 miliardë dollarë në vitin 2022, sipas grupit të ekspertëve.

Kina mbetet shpenzuesja e dytë më e madhe ushtarake në botë, duke ndarë rreth 292 miliardë dollarë në vitin 2022. Kjo ishte 4.2 për qind më shumë se në vitin 2021 dhe përfaqëson rritjen vjetore të 28-të radhazi.

Ndërkohë, Japonia ka shpenzuar 46 miliardë dollarë për ushtrinë

në vitin 2022, një rritje prej 5.9-përqindësh nga viti i kaluar. SIPRI ka theksuar se ishte niveli më i lartë i shpenzimeve ushtarake japoneze që nga viti 1960.

Japonia dhe Kina kanë kryesuar shpenzimet ushtarake në Azi dhe Oqeani, të cilat arritën në 575 miliardë dollarë. SIPRI tha se shpenzimet ushtarake në rajon ishin në rritje që nga viti 1989.

Tensionet në Azinë Lindore janë rritur mbi ishullin e vetëqeverisur të Tajvanit, të cilin Pekini e konsideron pjesë të territorit të vet. Kina, gjithashtu, pretendon pothuajse të gjithë Detin e Kinës Jugore, një rrugë kryesore tregtare detare, pjesë të së cilës pretendohen nga Filipinet, Vietnamit dhe Malajzia.

Japonia dhe Kina janë të përfshira në një mosmarrëveshje mbi ishujt Senkaku ose Diaoyu, të cilët shtrihen në verilindje të Tajvanit.

Tokio, gjithashtu, ka një mosmarrëveshje të gjatë me Moskën mbi Territorët Veriore, të cilat shtrihen në verilindje të Hokkaidos dhe u pushtuan nga Bashkimi Sovjetik në fund të Luftës së Dytë Botërore. Rusia i quan ata Ishujt Kuril.

Ministrat e BE-së kritikojnë Kinën për deklaratat lidhur me Ukrainën

BRUKSEL, 24 PRILL - Deklaratat e bëra së fundi nga ambasadori i Kinës në Francë, që vënë në pikëpyetje sovranitetin e ish-shteteve sovjetike, sikurse Ukraina, janë kritikuar nga disa ministra të Jashtëm të vendeve të bllokut evropian.

"Janë krejtësisht të papranueshme. Shpresoj që shefat e këtij ambasadori do t'i qartësojnë këto deklarata", ka thënë ministri i Jashtëm i Çekisë, Jan Lipavsky, para



nisjes së takimit në Luksemburg me homologët e tij nga shtetet e BE-së. Lidhur me qëndrimin e tij nëse Krimea - gadishulli ukrainas që

është aneksuar paligjshëm nga Moska më 2014 - ishte pjesë e Ukrainës ose jo, ambasadori kinez në Paris, Lu Shaye, ka thënë se historikisht ky gadishull ka qenë pjesë e Rusisë dhe i është dhënë Ukrainës nga ish-lideri sovjetik Nikita Khrushchev.

"Këto shtete të ish-Bashkimit Sovjetik nuk kanë status në të drejtën ndërkombëtare sepse nuk ka një marrëveshje ndërkombëtare

për ta materializuar statusin e sovranitetit të tyre", ka thënë Shaye në një intervistë për një televizion francez.

Ndërsa ministri i Jashtëm i Lituaniës, Gabrielius Landsbergis, ka thënë se deklarata të tilla "janë krejtësisht të papranueshme", duke shtuar se tri shtetet e Baltikut do t'i kërkojnë Kinës për të qartësuar nëse ka ndryshuar qëndrimin zyrtar.

Po ashtu, kundër deklaratave të ambasadorit kinez më herët janë deklaruar edhe Franca, Ukraina dhe tri shtetet e Baltikut.

Këto deklarata të ambasadorit kinez në Francë vijnë teksa pushtimi rus i Ukrainës është duke vazhduar. Kina, aleate e Rusisë, nuk e ka dënuar Moskën për veprimet e saj në Ukrainë, por ka kërkuar që konflikti të zgjidhet përmes dialogut.

Vazhdon evakuimi i diplomatëve dhe shtetasve të huaj nga Sudani

KHARTOUM, 24 PRILL - Një luftë e egër për pushtet midis ushtrisë së rregullt dhe një force të fuqishme paraushtarake ka çuar në trazira dhune në gjithë Sudanin për më shumë se një javë. Një numër i madh i vendeve kanë evakuuar diplomatët dhe qytetarët nga kryeqyteti i Sudanit. ShBA-ja dhe Britania e Madhe kanë njoftuar të dielën se kishin larguar diplomatët jashtë vendit.

Franca, Gjermania, Italia dhe Spanja, gjithashtu, kanë evakuuar diplomatët dhe shtetas të tjerë. Sipas "BBC"-së, autoritetet amerikane kanë thënë se kishin transportuar më pak se 100

persona me tre helikopterë. Me këtë rast, Ambasada e ShBA-së në Khartoum tani është e mbyllur dhe me anë të një postimi në "Twitter" ka shkruar se nuk është mjaft e sigurt nëse qeveria do t'i evakujë gjithë qytetarët amerikanë. Në anën tjetër, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar arriti t'i largonte diplomatët britanikë dhe familjet e tyre jashtë vendit.

Presidenti francez Emmanuel Macron ka konfirmuar se një aeroplan kishte mbërritur me qytetarë francezë. Ai ka bërë me dije se deri më tani janë evakuuar 388 qytetarë francezë. Edhe Italia

dhe Spanja i kanë evakuuar qytetarët, me ç'rast misioni spanjoll përfshinte evakuimin e shtetasve nga Argjentina, Kolumbia, Irlanda, Portugalia, Polonia, Meksika, Venezuela dhe Sudani. Në këtë mënyrë ka vepruar edhe kryeministri kanadez Justin Trudeau, duke deklaruar se qeveria e tij ka evakuuar stafin diplomatik

Në mes të kësaj trazire ka pasur thirrje të dëshpëruara për ndihmë nga shumë studentë të huaj, nga Afrika, Azia dhe Lindja e Mesme, të cilët janë të bllokuar në Khartoum. Ndërkohë, raportimet nga mediet botërore tregojnë se



lidhja e internetit është jashtë funksionit pothuajse totalisht në Sudan, gjë që mund të pengojë seriozisht koordinimin e ndihmës për të bllokuarit në Khartoum dhe qytete të tjera. Lufta për pushtet ka parë bombardime të rënda në

kryeqytet, me qindra të vrarë dhe mijëra të tjerë të plagosur.

Të shtënat dhe bombardimet pothuajse të vazhdueshme në Khartoum dhe gjetkë kanë ndërprerë energjinë elektrike dhe qasjen e sigurt në ushqim dhe ujë për pjesën më të madhe të popullsisë. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka deklaruar se luftimet kanë vrarë më shumë se 400 njerëz dhe kanë lënë mijëra të plagosur. Por numri i të vdekurve besohet të jetë shumë më i lartë pasi njerëzit po përpiqen të marrin kujdes shëndetësor, pasi shumica e spitaleve të qytetit janë detyruar të mbyllen nga luftimet.

Thaçi mbush 55 vjet

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka mbushur 55 vjet. Për dallim nga vitet e kaluara, kur ai festonte pranë familjes, kjo datëlindje Thaçin e gjen në Hagë, aty ku është duke u gjykuar kësaj here për krime lufte nga Gjykata Speciale. Me rastin e ditëlindjes, Thaçi është uruar nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. "Urime 55-vjetori i lindjes, president! Dielli do të lindë përsëri!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Po ashtu, Thaçi është uruar edhe nga kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci. Duke e quajtur Xhorxh Uashingtoni i Kosovës, Lladrovci ka thënë se Thaçi është krenari kombëtare. "Miku im, Hashim, njerëzit si ti janë të rrallë në histori, andaj ditëlindja jote është, po ashtu, e veçantë, edhe pse në rrethana të padëshirueshme. President, festo sot, sepse jo vetëm ti, por edhe të gjithë ne që kishim



fatin të jemi afër teje, kemi arsye për ta shënuar këtë ditë. Ti, Xhorxh Uashingtoni i Kosovës, ti që me shokë ke dhënë shumë për çlirim,

shtetformim e shtetndërtim dhe po vazhdoni t'i jepni ende të drejtës dhe luftës sonë për liri, ti që së bashku me shokët je krenari kombëtare, paç jetë

Mavraj ia uron ditëlindjen Thaçit: Ai ishte kryesori për krijimin e historisë së re të Kosovës

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Publicisti dhe botuesi Muhamet Mavraj e ka uruar për ditëlindjen e 55-të ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ndodhet në paraburgim në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Mavraj në "Facebook" ka shpërndarë një video të një interviste dhënë për procesin gjyqësor që po ndodh në Hagë, në të cilën ka veçuar një pjesë të saj kur flet për ish-udhëheqësin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi.

Mavraj në këtë intervistë, dhënë para Fakultetit Filozofik në Prishtinë (aty ku Thaçi i kreu studimet për histori), ka thënë se Kosova i ka disa historianë që shkruajnë historinë, por fare pak historianë që e krijojnë atë. Ndër ta, ka thënë ai, kryesori për krijimin e historisë së re të Kosovës është Hashim Thaçi.



Muhamet Mavraj

Shkrimi i plotë i Mavrajt:

Sot e ka ditëlindjen strategu i lirisë, Hashim Thaçi. GËZUAR! Edhe 55 të tjera në liri! Kur mbahet ai me shokë në burg, në dimë çfarë iu burgos Kosovës. Por, edhe e dimë çfarë duhet të bëjmë. Për ditëlindjen e tij po e risjellim këtë që kam thënë

këtu: MAVRAJ: Ai ka studiuar këtu, në këtë fakultet, prapa shpinës sonë këtu ku jemi, për historian. Kosova i ka disa historianë që shkruajnë historinë, por fare pak historianë që e krijojnë atë. Ndër këta, kryesori për krijimin e historisë së re të Kosovës, është Hashim Thaçi, pa asnjë dyshim.

të gjatë! Urime ditëlindja miku im, Hashim Thaçi!", ka shkruar Lladrovci në "Instagram". Ish-presidenti Thaçi ka marrë urimet më të mira për ditëlindje edhe nga qytetarët e Kosovës të cilët nëpër rrjete sociale i kanë uruar shëndet dhe rikthim në Kosovë. Hashim Thaçi, i lindur më 24 prill 1968, është presidenti i pestë i Republikës së Kosovës. Ai cilësohet si një nga protagonistët kryesor të shtetit

të Kosovës. Thaçi ishte kryeministri i parë i Kosovës së pavarur, ministër i Jashtëm dhe zëvendëskryeministër në kabinetin e kryesuar nga Isa Mustafa, i cili mori detyrën më 12 dhjetor 2014. Thaçi ishte, gjithashtu, lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Ai ishte ngritur në rend të parë si kreu politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Thaçi ka shërbyer edhe si kreu i një qeverie të përkohshme.



Endriti viziton babanë në Hagë: Ishte me disponim sikurse kur u çlirua Kosova

HAGË, 24 PRILL (ER) - Djali i ish-presidentit Hashim Thaçi, Endriti, e ka vizituar babanë në Hagë me rastin e 55-vjetorit të lindjes. Endriti ka treguar se Thaçi ishte mirë me shëndet dhe disponim të shkëlqyeshëm. Ai ka theksuar se babai i tij 55-vjeçar deri më tani ka kryer edhe 5 500 punë të vogla dhe të mëdha për atdheun. "Sapo e vizitova babain

për ditëlindje. Më priti me qeshje dhe hajgare, ishte me shëndet dhe disponim shkëlqyeshëm – sikurse kur u çlirua Kosova apo kur e shpalli pavarësinë. 55 vjet i bëri, por 5 500 punë të vogla e të mëdha po ashtu i ka kryer deri tash. Urime ditëlindja babë nga mami dhe unë. Vitin e ardhshëm e festojmë në shtëpi!", ka shkruar Endriti në "Instagram".

Edi Rama uron Thaçin për ditëlindje: Edhe 100 Komandant 🇷🇸



Sot ka qenë një ditë e vrenjtur edhe brenda meje. Zakonisht në këtë ditë të vitit jam mësuar, prej vitesh, t'i uroj ditëlindjen sivëllait tim, Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Dhe pengesa për t'ia uruar ditëlindjen një njeriu të dashur, të gjallë e të marrë peng në rrethana të njohura, jo nga forca të errëta e të panjohura, po nga Bashkësia e Lartë Ndërkombëtare, ka gjithë ditën që më rri mbi kokë si boshllëk i zymtë, thithës e lodhës.

Nuk desha ta bëj në mëngjes një urim digjital me foton e me fjalët që i thuhën dikujt që edhe mund ta marrësh në telefon, nuk e di, një ngërc në fyt më pengoi, një si inat prej pafuqisë ma ndaloi. As e kam dot idenë nëse sivëllau im do të mund t'i lexojë sot këto rreshta, që as urim nuk janë edhe pse urimin që të jetojë sa malet e Shqipërisë unë po e bëj, por di me siguri që në këtë ditëlindje të Hashim Thaçit kam tërë ditën që më rri si gozhdë e ngulur në tru pyetja: A e

dinin vallë ata, miqtë tanë të mëdhenj që e lindën atë gjykatë, se historia e saj do të zhvillohej kështu, kaq zyrtësisht e padrejtë me njerëz që luftuan për lirinë e popullit të tyre dhe me vetë Kosovën?! Kam frikë se të vërtetën për këtë s'kam për ta marrë vesh kurrë. Po ndoshta këtë frikë e kam nga vranësira brenda meje që s'ia urova dot ditëlindjen Hashimit me telefon, siç jam mësuar prej shumë vitesh.

Edhe 100 Komandant 🇷🇸

Pranohet aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KE)

Kosova një hap më pranë anëtarësimit në Këshillin e Evropës

Republika e Kosovës ka kaluar me sukses fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës (KE). Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare, me mbi dy të tretat e votave të nevojshme, i ka dhënë mbështetje të hënën aplikimit të Kosovës në KE, duke përmblytur kështu fazën e parë të anëtarësimit të plotë të shtetit tonë në këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare. Me këtë rast, liderët e institucioneve kanë shprehur bindjen se flamuri i Kosovës së shpejti do të valëvitet edhe në Këshillin e Evropës

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

STRASBURG, 24 PRILL - Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (KE) ka marrë vendim që t'ia përcjellë Asamblesë Parlamentare të kësaj organizate kërkesën për anëtarësimin e Kosovës. "Duke kujtuar marrëveshjen e Brukselit të 27 shkurtit 2023 dhe marrëveshjen e Ohrit të 18 marsit 2023 dhe aneksin e saj të zbatimit, të arritura në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, të udhëhequr nga përfaqësuesi i lartë, dhe rëndësinë që të gjitha palët t'i zbatojnë ato në mënyrë të përshtatshme dhe në mirëbesim, Këshilli i Ministrave vendosi t'i transmetojë Asamblesë Parlamentare për konsultim letërën e datës 12 maj 2022 drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Evropës (dokumenti DD (2022)200), pa cenuar shqyrtimin e ardhshëm nga Komiteti i Ministrave të kësaj kërkesë për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës", është thënë në njoftimin e Këshillit të Ministrave të KE-së. Ndërsa ministrja e Punëve të Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se me këtë vendim është përmblytur një etapë e rëndësishme drejt anëtarësimit të plotë të vendit tonë në KE. Ajo ka thënë se mbetet edhe shumë punë

për t'u bërë deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në KE. "Mbetet edhe shumë punë për të bërë. Procesi i anëtarësimit është i gjatë dhe plot sfida, por Republika e Kosovës në fund të procesit do ta zërë vendin e saj të merituar si anëtare e Këshillit të Evropës", ka shkruar Gërvalla, duke i falënderuar partnerët ndërkombëtarë për përkrahjen e këtij procesi. "Falënderoj nga zemra të gjithë ata që na mbështetën në rrugën tonë deri këtu. Një falënderim i posaçëm u shkon të gjithë atyre shteteve, të cilat, edhe pse nuk e kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës, nuk e kanë bllokuar anëtarësimin tonë. Nuk mund të lë pa falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat përsëri dëshmuar të jenë aleati më i rëndësishëm i Republikës së Kosovës dhe të cilat na mbështetën fuqishëm në dialogun tonë me një numër të madh të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës", ka shkruar Gërvalla, e cila i ka falënderuar edhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. "Falënderim i posaçëm i takon grupit ndërinstitucional të përbërë nga zyra e presidentes, zyra e kryetarit të kuvendit, zyra e kryeministrit dhe MPJD-ja, i cili udhëhiqet nga zëvendësministri Kreshnik Ahmeti, delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës



në Këshillin e Evropës, i cili udhëhiqet nga zëvendëskryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci, ekipit të Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Strasburg, e cila udhëhiqet nga ambasadori Lulzim Hiseni si dhe të gjithë atyre që kontribuuan sadopak për këtë ditë të rëndësishme. Kur në maj të vitit të kaluar, para më pak se një viti, dorëzuar në Këshillin e Evropës kërkesën për anëtarësim, numri i skeptikëve ishte i madh. Sot e dimë se sa i rëndësishëm dhe vendimtar ka qenë guximi i atyre ditëve. Falë vullnetit të palëkundur të qytetarëve të Republikës së Kosovës për sundim të ligjit dhe demokraci, të shprehur në votën masive të 14 shkurtit, Kosova, si shembulli më i mirë i demokracisë në rajon, do të ecë e sigurt në rrugën e saj

euroatlantike. Ka edhe shumë punë për të bërë, shumë sfida për të përballuar, por dita e sotme meriton të festohet denjësisht. Urime nga zemra të gjithëve!", ka shkruar Gërvalla. Edhe kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se Kosova e ka kaluar me sukses fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. "Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare, me mbi dy të tretat e votave të nevojshme, i dha sot mbështetje aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, duke përmblytur kështu fazën e parë të anëtarësimit të plotë të Republikës sonë në këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare. Shteti ynë do të jetë vlerë e shtuar për Këshillin e Evropës. Këshilli i Evropës do t'i shtojë vlerë demokracisë, të drejtave të njeriut

dhe sundimit të ligjit në shtetin tonë. Falënderoj ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ministrin Gërvalla, zëvendësministrin Ahmeti dhe ekipet e tyre për punën e pandërprerë, si dhe partnerët tanë e shtetet anëtare për përkrahjen e pakursyer", ka shkruar Kurti në "Facebook". Këshilli i Evropës, organizata më e vjetër evropiane që merret me zhvillimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, ka procedurë të caktuara për pranimin e anëtarëve të rinj. Këto procedura kalojnë përmes Këshillit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare, ku marrin pjesë deputetët nga parlamentet e shteteve anëtare. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës më 12 maj 2022.

Osmani: Flamuri i Kosovës së shpejti do të valëvitet edhe në Këshillin e Evropës

Presidentja e Vjosa Osmani ka reaguar të hënën pas pranimit të aplikacionit të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Me këtë rast, Osmani ka thënë se

flamuri i Kosovës shumë shpejt do të valëvitet edhe në KE. "Së shpejti flamuri i Republikës së Kosovës do të valëvitet edhe në Këshillin e Evropës. Faleminderit aleatëve

tanë që sot votuan jo vetëm për Kosovën por, mbi të gjitha, për demokracinë, lirinë dhe të drejtat e njeriut!", ka shkruar Osmani në "Facebook".

dhe vitet në vijim. Ne nuk kemi nevojë për ndonjë konflikt me NATO-n, nuk jemi të aftë për këtë, por nuk jemi në një situatë që ta lejojë poshtërimin e mëtejshëm të popullit tonë. Situata vetëm sa do të ndërlkohet", ka thënë Vuçiqi. Ai ka thënë se zgjedhjet paraqesin "dëshitim të regjimit të (kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti)". "Nën një, (zgjedhjet e 23 prillit) janë debakël zgjedhor i Kurtit dhe Quintit", ka thënë Vuçiqi, duke iu referuar grupit të shteteve ku bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia. "Nën dy, ky është një rezultat historik sepse nuk ka ndodhur kurrë në tokën evropiane. Nën tre, kjo tregoi unitetin e madh të popullit serb, disiplinën dhe përgjegjësinë e serbëve, gjë që nuk është parë në historinë moderne të kombit tonë". Sipas Vuçiqit, zgjedhjet e 23 prillit ishin "referendum" për serbët që jetojnë në veri, për "të treguar se kë nuk duan në veri të Kosovës".

Vuçiqi, po ashtu, ka folur edhe për dialogun me Kosovën që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Ai ka thënë se "nuk ka fare dialog substancial", duke i akuzuar shtetet e Quintit se favorizojnë Kosovën. "Ne nuk bisedojmë. Marrim letra të imponuara që gjithmonë duhet të jenë në favor të Prishtinës, sepse Quinti është i tillë, përkrah pavarësinë e Kosovës pak a shumë, por gjithmonë është në favor të saj", ka thënë Vuçiqi. Vuçiqi së bashku me Kurtin pritet të takohen më 2 maj, në raundin e ri të dialogut, që synon normalizimin e plotë të raporteve mes dy shteteve. Në agjendë të takimit pritet të jetë edhe draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Themelimi i këtij asociacioni është paraqitur si kusht për kthimin e serbëve në institucionet e Kosovës. Megjithatë, Vuçiqi ka thënë se nuk ka marrë ende një vendim nëse do të marrë pjesë në raundin e ri të dialogut, "por me siguri do të

BE-ja: Zgjedhjet në veri, në përputhje me ligjet e Kosovës, serbët të kthehen në institucione

Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se zgjedhjet në katër komunat veriore janë mbajtur në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës. Në të njëjtën kohë, BE-ja ka shprehur keqardhjen që jo të gjitha partitë dhe komunitetet e shfrytëzuan të drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë dhe votuar në zgjedhje. "Këto zgjedhje nuk ofrojnë zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna. Kjo mund të ndodhë vetëm përmes

kthimit të përhershëm të serbëve të Kosovës në institucione dhe që Kosova ta mundësojë këtë kthim. Puna për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të finalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Është e domosdoshme që urgjentisht të rivendosim një situatë ku serbët e Kosovës të marrin pjesë aktivisht në qeverisjen lokale, policinë dhe gjyqësorin në veri të Kosovës. Për

këtë ka nevojë urgjente për një dialog serioz ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe serbëve të Kosovës në veri. Deri më tani është bërë pak përparim. Prandaj, ne kemi nevojë që të dyja palët ta luajnë rolin e tyre dhe t'i përmbushin angazhimet e tyre", është thënë në reagimin e BE-së. Se zgjedhjet në veri kanë qenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës ka thënë një ditë më parë edhe ShBA-ja.

shkojë në Bruksel më 2 maj".

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje, Erden Atiq dhe Lulzim Hetemi, kanë fituar në Mitrovicë të Veriut, përkatësisht në

Leposaviq. Ndërkaq, kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës, Izmir Zeqiri dhe Ilir Peci, kanë fituar në Zubin Potok, përkatësisht në Zveçan. Pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë e ulët. Sipas KQZ-së, në të katër komunat kanë votuar 1 567

qytetarë apo 3.47 për qind e trupit votues prej 45 095 qytetarësh me të drejtë vote. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, ka refuzuar pjesëmarrjen në këto zgjedhje dhe ka bërë thirrje për bojkotim të procesit.



VAZHDOJNË REAGIMET PËR ZGJEDHJET E MBAJTURA NË VERI TË KOSOVËS

Bojkotimi i zgjedhjeve nga serbët, Osmani dhe Kurti akuzojnë Serbinë për shantazh

Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti e kanë përgëzuar KQZ-në, por edhe institucionet e sigurisë për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës të cilët janë bojkotuar nga serbët lokalë. Osmani dhe Kurti kanë thënë se ky bojkot ka ndodhur për shkak të ndërhyrjes së Beogradit zyrtar përmes presionit dhe shantazhit. Pavarësisht prej kësaj, Osmani dhe Kurti janë zotuar se do të jenë pranë qytetarëve atje dhe kryetarëve të zgjedhur. Ka folur edhe BE-ja, e cila ka theksuar se zgjedhjet në katër komunat veriore janë mbajtur në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 24 PRILL - Një ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave në veri të Kosovës, kanë reaguar presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. Osmani nëpërmjet një deklarate publike e ka përgëzuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe organet e drejtësisë për organizimin e këtyre zgjedhjeve dhe ofrimin e sigurisë. “Përgëzoj Komisionin Qendror Zgjedhor për përgatitjet e bëra, të cilat mundësuan realizimin e procesit të votimit për zgjedhje të jashtëzakonshme komunale në komunën e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Falënderoj, po ashtu, të gjitha institucionet e sigurisë për punën profesionale, të cilat siguruan një ambient të qetë e të

sigurt për gjatë procesit zgjedhor, i cili ishte shtyrë nga dhjetori 2022 për në prill 2023. Institucionet e Kosovës u mundësuan qytetarëve realizimin e të drejtës për pjesëmarrje në zgjedhje në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe treguan se grupet kriminale që janë të dirigjuara nga Serbia nuk mund t’i diktojnë proceset kushtetuese e ligjore në Republikën e Kosovës”, ka thënë Osmani.

Po ashtu, Osmani i ka falënderuar edhe qytetarët të cilët kanë marrë pjesë në këto zgjedhje përkundër ndërhyrjes së paligjshme të Serbisë dhe strukturave kriminale. “I falënderoj të gjithë ata qytetarë që morën pjesë në votim përkundër ndërhyrjes së paligjshme të Serbisë dhe strukturave të saj kriminale për ta pamundësuar një gjë të tillë. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve kriminale, shumë qytetarë serbë të

këtyre komunave u kërcënuan dhe u shantazhuan me qëllim që mos të marrin pjesë në procesin zgjedhor dhe kësaj mënyre të mos mund ta shprehin vullnetin politik për t’i zgjedhur përfaqësuesit e tyre lokalë”, ka thënë Osmani.

Më tutje, Osmani ka thënë se ndërhyrja në procese zgjedhore është bërë problem global. “Ndërhyrja nga jashtë në procese zgjedhore është një problem global për botën demokratike, e cila jo vetëm që mëton ta minojë vullnetin qytetar, por edhe cenon parimin e barazisë sovraane të shteteve, si një nga normat themelore të rendit ndërkombëtar. Republika e Kosovës ka shprehur zotimin e saj në Samitin për Demokraci, të organizuar nën përkujdesjen e presidentit Biden, për të qëndruar krah përkrah me shtetet demokratike për ta luftuar dukurinë në rritje të ndërhyrjes nga jashtë në procese zgjedhore”, ka thënë Osmani, duke e akuzuar Serbinë për shkeljen e marrëveshjes së Brukselit për shkak të pengimit të zgjedhjeve në veri të Kosovës. “Angazhimi i vazhdueshëm dhe i hapur i Serbisë për ta penguar zhvillimin e zgjedhjeve të lira në Republikën e Kosovës është kundër frymës dhe shkronjës së Marrëveshjes së fundit të arritur në Bruksel, së bashku me planin implementues. Si e tillë, kjo qasje e Serbisë duhet të kundërshtohet nga e gjithë bota demokratike, meqë njëkohësisht paraqet edhe akt të ndërhyrjes së paligjshme nga jashtë, akt ky që dënohet me një sërë aktesh juridike ndërkombëtare”, ka deklaruar

Osmani.

E para e shtetit ka theksuar se do të qëndrojnë pranë qytetarëve në katër komunat veriore të Kosovës. “Institucionet e Kosovës do t’i shtojnë përpjekjet dhe do të qëndrojnë pranë të gjithë qytetarëve në katër komunat e veriut të Kosovës, në mënyrë që të mbrohen nga kërcënimet e strukturave ilegale. Institucionet e Kosovës, po ashtu, do t’i bashkërendojnë veprimet me aleatët strategjikë për t’i ndaluar veprimet e mëtejshme destabilizuese të Serbisë, të cilat janë edhe në kundërshtim me marrëveshjen e fundit të Brukselit. Jemi të vendosur që së bashku me qytetarët e këtyre komunave të punojmë për kushte gjithnjë e më të mira jetese, më shumë demokraci dhe mirëqenie në secilën lagje të secilës komunë”, ka thënë Osmani.

Kurti: Beogradi dhe veglat e tij kriminale imponuan bojkotin

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur për zgjedhjet që janë mbajtur dje në katër komunat në veri. Ai në “Facebook” e ka falënderuar KQZ-në për organizimin e zgjedhjeve, Policinë e Kosovës për sigurinë dhe qytetarët për mbështetjen. Kurti ka shkruar se bojkoti i zgjedhjeve në veri ishte i imponuar nga fushata kërcënuese e Beogradit zyrtar dhe veglave të tij kriminale në veri. “Atmosfera ishte ajo e frikësimit dhe shantazhit andaj

edhe dalja e qytetarëve në zgjedhje ishte e ulët. Bojkoti ishte i imponuar nga fushata kërcënuese e Beogradit zyrtar dhe e veglave të tij kriminale në terren në veri. I falënderoj qytetarët për kurajën dhe qetësinë”, ka shkruar Kurti.

Kurti i ka uruar kryetarët dhe asamblistët e zgjedhur, të cilët i ka siguruar që qeveria do t’i përkrahë dhe t’i ndihmojë. “I uroj kryetarët dhe asamblistët e zgjedhur dje. Ata duhet të punojnë me përkushtim dhe të shërbejnë pa dallim. Qeveria do t’i përkrahë e ndihmojë. Sistemi institucional dhe shërbimet publike do të mund të funksionojnë më shumë e më mirë. Për mirëqenien e qytetarëve dhe të drejtat e tyre”, ka shkruar Kurti.

Vuçiqi: Ndryshime tektonike në veri të Kosovës

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale të mbajtura më 23 prill në katër komunat në veri të Kosovës “kanë ndodhur ndryshime tektonike”. “Dje (e diel) populli serb tregoi se kërkon një qasje krejtësisht të ndryshme, para së gjithash nga bashkësia ndërkombëtare dhe, para së gjithash, po u referohem fuqive perëndimore”, ka thënë Vuçiqi të hënën në një konferencë për gazetarë.

Vuçiqi ka thënë, gjithashtu, se të dielën është zhvilluar një “kryengritje politike, paqësore e popullit serb”. “Kam frikë se ky është preludi i një krize shumë më të madhe dhe më të thellë në muajt

Qasja në objektet komunale, sfida e parë e kryetarëve të rinj

PRISHTINË, 24 PRILL - Katër kryetarët e rinj shqiptarë në komunat në veri të Kosovës e kanë pranuar se do ta kenë të vështirë qasjen në zyrat e tyre të reja pasi shumica gjenden në objektet e strukturave paralele komunale serbe. Ata kanë thënë se janë të vetëdijshëm për sfidat, por presin ndihmë nga Qeveria e Kosovës që të mundësojë nisjen e punës së tyre.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe politologu serb nga Mitrovica e Veriut, Ognjen Gogiq, kanë thënë se pengesat e para me të cilat do të ballafaqohen këta kryetarë të zgjedhur do të jenë: qasja në objektet komunale, dhënia e betimit solemn dhe ushtrimi efektiv i mandatit.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale të 23 prillit në komunat me shumicë serbe – Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq – kanë garuar nëntë shqiptarë dhe një kandidate nga komuniteti serb.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje, Erden Atiq dhe Lulzim Hetemi, kanë fituar në Mitrovicë të Veriut, përkatësisht në Leposaviq. Ndërkaq, kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës, Izmir Zeqiri dhe Ilir Peci, kanë fituar në Zubin Potok, përkatësisht në Zvečan.

Pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë e ulët. Sipas KQZ-së, në të katër komunat kanë votuar 1 567 qytetarë apo 3.47 për qind e trupit votues prej 45 095 qytetarësh me të drejtë vote.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, ka refuzuar pjesëmarrjen në këto zgjedhje dhe ka bërë thirrje për bojkotimin e procesit. Me gjithë thirrjet e autoriteteve të Kosovës për të dalë në votime, pjesëtarët e komunitetit serb nuk janë përgjigjur.

Nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq, ka thënë se populli serb në Kosovë “nuk do të lejojë kurrë” që komunat me shumicë serbe në veri të vendit të udhëhiqen nga ata që kanë fituar “1 apo 2 për qind të votave” në zgjedhje, por nuk ka saktësuar se çfarë masash mund të ndërmerren.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se kryetarët e zgjedhur më 23 prill janë legalë, por nuk kanë legjitimitet praktik dhe përfaqësues për shkak se nuk kanë marrë vota nga komuniteti serb, i cili është shumicë në katër komunat në veri të Kosovës. Sipas tij, problemi i parë me të



cilin do të ballafaqohen kryetarët e rinj do të jetë qasja fizike në objektet e komunave, në shumicën e të cilave janë të vendosura edhe strukturat që punojnë sipas sistemit të Serbisë. “Afati 30-ditor, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, është relativisht i shkurtër. Në rast se nuk gjendet ndonjë modalitet kreativ, unë besoj se do ta ketë tejet të vështirë secili nga katër kryetarët e rinj që në objektin komunal, përkatësisht në kuvendet komunale, të arrijë ta japë betimin. Pra, është tejet e vështirë – për të mos thënë e pamundur – që këta kryetarë të arrijnë që këtë vullnet qytetar, të komunitetit shqiptar në këto komuna, ta materializojnë dhe ta jetësojnë në praktikë, duke funksionalizuar si institucione dhe duke dhënë shërbime”, ka thënë Cakolli. Ai ka thënë se edhe nëse kryetarët e japin betimin, ky do të jetë një formalitet, i cili në praktikë nuk do të ketë fare efekt.

Mendim të ngjashëm ka shprehur edhe politologu serb Ognjen Gogiq. Ai ka vlerësuar se sfidë e madhe do të jetë kompletimi i asambleve komunale, para të cilave kryetarët, ligjërisht, duhet ta bëjnë betimin.

Në rast se cilido kryetar i zgjedhur nuk arrin ta kryejë këtë procedurë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, atëherë sërish shkohet në zgjedhje. “Madje, edhe nëse ndodh që ata marrin detyrën dhe shpallen zyrtarisht kryetarë të komunave, atëherë shtrohet pyetja se si do të punojnë në ato komuna, marrë parasysh që në to nuk ekzistojnë më kuadrot, nuk ekziston pjesa e shërbyesve... Të gjithë ata kanë dhënë dorëheqje. Kështu që, kur ata do të duhej t’i udhëhiqnin ato vetëqeverisje lokale në ato

komuna, ata nuk do të kenë në kë të mbështeten për t’i zbatuar vendimet. Nuk kanë as objekte, sepse në disa prej këtyre komunave ata i ndajnë hapësirat me organet e përkohshme që punojnë sipas sistemit serb”, ka thënë Gogiq për “Radion Evropa e Lirë”.

“Qeveria duhet të na ndihmojë”

Kandidatët që, sipas rezultateve preliminare, kanë fituar në katër komunat në veri të Kosovës, presin që të përballen me sfida për tejkalimin e të cilave kanë thënë se do ta kërkojnë mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Qasja fizike në objektet e komunave në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan, kryetarët e rinj të tyre e pranojnë se do të jetë sfidë për ta dhe për kabinetet e tyre për shkak se në to janë të pranishme edhe strukturat e të ashtuquajturave organe të përkohshme që punojnë sipas sistemit të Serbisë.

Komuna e Mitrovicës së Veriut, ndërkaq, e ka objektin e saj, ku janë të vendosura shërbimet në kuadër të sistemit të Kosovës. Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje, Erden Atiq, si më i votuari në garën për kryetar të Mitrovicës së Veriut, ka thënë të dielën para gazetarëve se nuk e sheh problem qasjen në objektin e komunës. “Si në një komunë normale në një lagje mesatare të Republikës së Kosovës. Për të gjitha sfidat jemi të vetëdijshëm dhe jemi të përgatitur. Do të jem kryetar i të gjithëve, pa marrë parasysh a janë përkrahës apo jo”, ka thënë Atiq.

Lulzim Hetemi, po ashtu kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje, i cili ka marrë më së shumti vota

për kryetar të komunës së Leposaviqit, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se, paraprakisht, ka marrë premtimin nga Qeveria e Kosovës se do të ndihmojë në funksionalizimin e institucioneve lokale. “Tash duhet të na ndihmojë. Na ka premtuar se do të bëjë investime, si të shqiptarët, ashtu edhe të serbët. Ta shohim tash se si do të reagojë”, ka thënë Hetemi.

Në pritje të vendimit të qeverisë

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës, Ilir Peci, i cili ka fituar në garën për kryetar të komunës së Zveçanit, ka pranuar se sfidat janë të pritshme dhe se një ndër to është qasja në objektin e komunës. “Tash krejt varet nga institucionet e Kosovës se çfarë vendimi do të marrin. Tash neve dhe ekipin tonë, a na dërgojnë në komunën e Zveçanit [në objektin komunal]... Kjo është pak problem. Qeveria duhet të na tregojë se çfarë vendimi do të marrim. Pra, të veprojmë ne apo qeveria të na ndihmojë. Janë disa gjëra që tash nuk mund t’i them saktë”, ka thënë Peci për “Radion Evropa e Lirë”. Izmir Zeqiri nga PDK-ja, i cili, sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, ka fituar garën për kryetar të komunës së Zubin Potokut, ka thënë se komuna ka edhe objekte të tjera ose ofiqari në vendbanimet e banuara me shqiptarë, të cilat mund të shfrytëzohen nga struktura e re udhëheqëse e komunës, në rast se objekti kryesor nuk lirohet nga strukturat e shtetit serb. “Momentalisht, nuk do të synojmë ta marrim objektin, mirëpo ne e konsiderojmë si të uzurpuar. Prioritet e kam

konsolidimin, formimin e kabinetit qeveritar dhe ofertën për t’i përfshirë të gjithë ata (pjesëtarët e komunitetit serb). Unë do të bëj ftesë që të kyçen në sistem, të punojmë bashkë”, ka thënë Zeqiri për “Radion Evropa e Lirë”.

Më tutje, ish-ministri i Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, ka thënë se kryetarët e rinj të komunave duhet të parashikojnë se si të veprojnë në rast se mund të ketë ndonjë bojkotim të administratës komunale. “Kryetari, pa pjesën e administratës, nuk mund të ofrojë shërbime për qytetarët. A do të ketë bojkot? Mund të ketë edhe thirrje për qytetarët që të mos marrin shërbime në komunë. Mandej, edhe ai presioni që do t’u bëhet më tutje serbëve që të mos bashkëpunojnë me të zgjedhurit e rinj”, ka thënë Ferati për “REL”-in.

Kurse ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka shprehur bindjen se kryetarët e rinj të komunave në veri të Kosovës, nuk do të kenë probleme në punën e tyre sepse, siç ka thënë, “ligji do të zbatohet në të gjithë vendin”.

Duke folur për “REL”-in, më 23 prill, ministri Sveçla ka thënë se kryetarët e rinj “do të punojnë normalisht në objektet shtetërore të Kosovës” dhe se “të gjitha objektet e administratës në Republikën e Kosovës janë pronë e shtetit”.

Zgjedhjet e parakohshme në komunat veriore janë mbajtur për shkak se kryetarët e tyre - të gjithë nga radhët e Listës Serbe - kanë dhënë dorëheqje në nëntor të vitit të kaluar në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Ambasadori amerikan: E mbështet planin 10-vjeçar të FSK-së për t'u bërë forcë shumetnike

PRISHTINË, 24 PRILL - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka takuar të hënën gjeneralin e brigadës së Iowas, Stephen Osborn. Hovenieri ka

thënë se e mbështet planin 10-vjeçar të Forcës së Sigurisë së Kosovës për t'u bërë forcë shumetnike, profesionale, e ndërveprueshme nga NATO-ja për mbrojtjen territoriale.

“Kënaqësi ta mirëpresim gjeneralin e brigadës së Iowas, Stephen Osborn, në Kosovë. Ne e vlerësojmë partneritetin e qëndrueshëm të Iowas me FSK-në pasi e mbështetim

planin 10-vjeçar të FSK-së për t'u bërë një forcë shumetnike, profesionale, e ndërveprueshme nga NATO-ja për mbrojtjen territoriale”, ka shkruar Hovenier në “Twitter”.



Kurti i gatshëm për takimin e radhës me Vuçiçin, pret rezultate konkrete



PRISHTINË, 24 PRILL - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në takimin e radhës me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, do të diskutohet se si marrëveshja e Ohrit në mes të Kosovës dhe Serbisë do të zbatohet pa vonesa. Ai ka thënë se është i gatshëm për takimin e 2 majit me presidentin serb dhe se pret rezultate konkrete nga ai takim.

“Gjithmonë jam gati për takimet e nivelit të lartë. Takimi i radhës do të mbahet në Bruksel. Duhet të diskutohet se si edhe marrëveshje e Brukselit dhe marrëveshja e Ohrit do të zbatohen pa vonesa e plotësisht”, ka theksuar Kurti. Kurti këto komente i ka bërë pas ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit për nisjen e

aktivitetit të mbështetur nga USAID-i, të partneritetit me sektorin privat për forcimin e arsimit të lartë. Ai ka thënë se nuk i ka rënë pishman që është kryeministër. “Unë nuk jam penduar që jam kryeministër. Besoj që njësoj e kanë ndjenjën kolegët e mi nga qeveria e, padyshim, edhe shumica e qytetarëve të Kosovës. Është evidente që me zgjedhjet e 14

shkurtit 2021 kanë ndryshuar legjislativi dhe ka ndryshuar ekzekutivi, ka filluar transformimi i madh demokratik e zhvillimor i vendit tonë”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se vendit i duhet një sitëm gjyqësor efikas. “Ajo që është e domosdoshme është një sistem i drejtësisë, një prokurori aktive, një gjyqësor efikas, që të gjithë këta të jenë

të mençurr, të ditur me një integritet profesional dhe personal e patriot në mënyrë që të sjellin edhe drejtësi për qytetarët. Kur them drejtësi, mendoj edhe për viktimat e luftës për shkak të agresionit dhe gjenocidit të Serbisë, por edhe për viktimat e korrupsionit e krimit të organizuar në periudhën e paqes”, është shprehur Kurti.

Dështon mbledhja e kryesisë së Kuvendit, Kusari-Lila fajëson opozitën

PRISHTINË, 24 PRILL - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se të hënën nuk ka arritur të mbahet mbledhja e rregullt e kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ajo në një konferencë për medie ka thënë se mbledhja nuk është mbajtur si pasojë e mungesës së anëtarëve të

kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ndër të tjera, ajo është shprehur se deputetët e opozitës në seanca dhe në mbledhje të kryesisë së Kuvendit janë duke abstenuar vazhdimisht për propozimet dhe projektligjet që bëhen. “E konsiderojmë totalisht të papranueshme dhe tërësisht jo të

përgjegjshme abstenimin e vazhdueshëm të opozitës. Arsyetimet se pozita e mban përgjegjësinë tashmë nuk pinë ujë për shkak se puna dhe përgjegjësinë që e marrin deputetët është miratimi i projektligjeve, me votimet e ndryshme të raporteve, natyrisht edhe votimet në Kuvend”, ka thënë Kusari-Lila.



UP-ja do t'i hulumentojë rastet e ngacmimeve seksuale

PRISHTINË, 24 PRILL - Shumë shpejt Universiteti i Prishtinës (UP) do të fillojë një hulumentim në të gjitha njësitë akademike për rastet e ngacmimeve seksuale. Lajmin e ka dhënë zyrtarja për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimet seksuale në këtë universitet, Drita Hyseni. Por ekspertët thonë se studentët duhet të vetëdijesohen për denoncimin e rasteve. Hyseni ka thënë se në kuadër të Rregullores për Parandalimin e Ngacmimeve Seksuale, së bashku me prorektoren Njomza Llullaku dhe me mbështetjen e menaxhmentit, janë përgatitur pyetjet dhe janë në përfundim të metodologjisë së hulumentimit, ku fokus i

pyetësorit janë studentët. "Nuk do të kenë as emër e as mbiemër. Neve na duhen vetëm të dhënat nga terreni për ta parë gjendjen faktike. Po bëhet një hulumentim për herë të parë për sa i përket kontekstit të ngacmimeve seksuale në Universitetin e Prishtinës. Do të ketë edhe një raport final. Besoj se deri në muajin qershor do të realizohet. I kemi formuar grupet punuese, të cilët do të punojnë për t'i mbledhur të dhënat dhe për ta çuar deri në fund këtë kauzë dhe ta vërtetojmë nëse është fenomen i dukshëm në UP", ka thënë ajo për "Radio Kosovën". Hyseni ka bërë me dije se nga viti i kaluar e deri tani janë



raportuar pesë raste të ngacmimeve në Universitetin e Prishtinës. Më tutje, ajo ka sqaruar se me Rregulloren për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimet Seksuale dhe

Ngacmimi në Universitet, përcaktohen edhe procedurat disiplinore dhe masat e zbatueshme në rastet e tilla. "Në vitin 2022 kanë qenë katër raste, ndërsa në vitin 2023 një

rast. Këshilli i Etikës ka marrë tri vendime, ndërsa në procedurë janë dy. Gjithashtu, është edhe vendimi i senatit të Universitetit të Prishtinës për rastin e fundit ndaj profesor Bekim Bejta", ka thënë ajo. Ndërsa drejtori i Institutit "EdGuard", Rinor Qehaja, ka thënë për "Radio Kosovën" se ngacmimet seksuale në institucione arsimore, përveç që me ligj, duhet të denoncohen edhe me rregullore të secilit institucion. Në anën tjetër, Policia e Kosovës në një përgjigje përmes adresës elektronike ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i rasteve nga vepra penale "ngacmimi seksual" për vitin 2022 ishte 91.

Mbi 600 të rinj nga komunitetet përfitojnë praktikë me pagesë

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në ngjarjen e organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me përfitues nga komunitetet joshumicë të programit "Kosova Generation Unlimited", praktikë me pagesë.

Kurti ka thënë se me ardhjen në pushtet ka filluar t'i realizojë premtimet primare që ishin punësimi dhe drejtësia. Ai ka thënë se me këtë projekt përfitojnë mbi 600 të rinj që kanë mundësi kryerjen e praktikës dhe që do të paguhen. "Me ardhjen tonë në qeverisje filluam t'i realizojmë premtimet tona, punësim dhe drejtësi. Me këtë projekt jemi më afër



përbushjes së zotimit tonë. Kjo ju mundëson që edhe ta kryeni praktikën edhe të paguheni. Ne e dimë se sa

Kosova ka pasur probleme me papunësi dhe e ka pasur popullatën më të re në vazhdimësi në botë. Për

potencialin tuaj jemi optimistë. Një numër i madh i të rinjve nuk janë në punë, në shkollë, apo në ndonjë trajnim. 30 për qind e të rinjve janë në një gjendje të tillë. Ajo e komuniteteve është edhe më e madhe. Për këtë qeveria ka ndërmarrë hapa. Ka ndarë pako prej 3 milionë eurosh. Nga ky projekt kemi mbi 600 të rinj të punësuar dhe 500 biznese të reja. Krahas kësaj nisme, qeveria ka lansuar edhe platformën 'Vetëpunësimi', ku deri më tani kemi mbi 4 700 pozita punë, 3 700 biznese të regjistruar e mbi 2 000 marrëdhënie pune", është shprehur Kurti.

Ndërsa ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se është shumë e rëndësishme që të punohet për uljen e papunësisë

ngaqë, sipas tij, është edhe prioritet i kësaj ministrie. Në anën tjetër, Zana Bjajrami-Rama, drejtoreshë e rrjetit CSR Kosova, ka thënë se duan të ketë sa më shumë diversitet ndërmjet bizneseve si dhe më shumë gjithëpërfshirje. "Duke pasur parasysh se fuqizimi i të rinjve është një element kyç, është i fokusuar në mobilizimin e biznesit për t'iu mundësuar të rinjve punësim. Ajo që ne duam të arrijmë është sa më shumë diversitet ndërmjet bizneseve dhe gjithëpërfshirje. Ajo që duhet të ketë rëndësi për ne si komunitet i biznesit është të gjenerojmë punë cilësore, andaj i ftoj bizneset dhe të rinjtë ta ftoni rrethin tuaj për t'i përdorur", ka thënë ajo.

Vitia: Rritja e imunizimit përmes vaksinimit mbron popullatën nga sëmundjet infektive

PRISHTINË, 24 PRILL - Në Kosovë ka filluar "Java Botërore e Imunizimit", me moton "Zëre hapin" ("Catch-up"). Në tryezën e mbajtur në Prishtinë, ku të pranishëm ishin përfaqësuesit e OBSH-së, UNICEF-it, USAID-it dhe IKShPK-së, janë theksuar përpjekjet që po bëhen në mbarë botën për t'i rikuperuar pasojat që ka shkaktuar pandemia Covid-19 dhe angazhimet për ngritjen e shkallës së vaksinimit me vaksinat e programeve të rregullta të imunizimit.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se ministria që drejton ka punuar ngushtë me partnerët për fuqizimin e kapaciteteve aktuale të zinxhirit të ftohtë të vaksinimit përmes ngritjes së depon moderne për ruajtjen e vaksinave, përmirësimin e rrjetit transportues të vaksinave si dhe

zbatimin e vaksinimit plotësues "Catch-up", me qëllim të mbulueshmërisë sa më të lartë të popullatës me vaksinim. "Imunizimi është një nga ndërhyrjet kyçe për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet serioze infektive që rrezikojnë shëndetin, të cilat përmes vaksinimit janë të parandalueshme. Përmes ofrimit falas të vaksinave për popullatën synohet të rritet shkalla e imunizimit, respektivisht arritja e mbulueshmërisë universale të imunizimit", ka thënë ministri Vitia.

Më tutje, ai ka thënë se Plani i Veprimit për Vaksinim 2022-2025 përmban risi sa i përket përfshirjes së vaksinave të reja në programin e rregullt të vaksinimit, meqë në këtë plan janë përfshirë Vaksina HPV (vaksina kundër Human

Papilloma Virusit), Rota Vaksina (vaksina e Rotavirusit) dhe Pneumokok Vaksina (vaksina kundër Pneumonisë, Meningjtit dhe Sepsës). "Përfshirja e këtyre vaksinave në programin e rregullt të vaksinimit pritet të rezultojë me ulje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga sëmundjet si: kanceri i qafës së mitrës, infeksionet me Rotavirus të fëmijët dhe sëmundje të ndryshme që shkaktohen nga tipa të ndryshme të pneumokokut", ka thënë Vitia. Në hapje të "Javës Botërore të Imunizimit" në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë është organizuar edhe ekspozita "Historiku i vaksinimit në Kosovë", ku është paraqitur një historik i programit të obligueshëm për imunizim që për herë të parë filloi në vitin 1948 me vaksinën kundër



tuberkulozit dhe vazhdoi me vaksinën kundër difterisë (1950), tetanus (1955), pertussis (1959), polio (1961), fruthi (1971) dhe kështu me radhë, përfshirë edhe vaksinimin kundër Covid-19.

Përditësimi i kalendarit të rregullt të vaksinimit është bërë ndër vite, ndërkohë që aktualisht në Kosovë kalendari i vaksinimit të rregullt përfshin 10 sëmundje të parandalueshme me vaksina.

Diskutohet për nevojat e tregut të punës, theksohet rëndësia e përfaqësimit të grave

PRISHTINË, 24 PRILL - Për nevojat e tregut të punës dhe hartimin e politikave për përshtatje ndaj këtyre nevojave është diskutuar të hënën në konferencën STEMInists, ku panelistë kanë qenë edhe ministra të qeverisë Kurti. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se qeveria ka reformuar integrimin e tregut të punës, e si shembull konkret të kësaj ka përmendur edhe angazhimin në kuadër të platformës "Superpuna". Murati ka thënë se platforma, mes të tjerash, ka për qëllim edhe integrimin e grave në tregun e punës. "Për integrimin në tregun e punës jemi duke punuar ngushtë me të gjitha ministrat e linjës, por edhe me aktorët e tjerë, pra për një program kyç që shtyhet nga Bashkimi Evropian dhe ne jemi duke bërë reforma në këtë drejtim. Kemi filluar implementimin e disa masave zbatuese siç është



'Superpuna', për ta shtyrë përpara edhe integrimin e grave në tregun e punës dhe po i shohim rrethanat se si po shkon tregu i punës", ka thënë Murati, teksa ka përmendur edhe ndërtimin e disa çerdheve dhe shtimin e stafit për nivelin parashkollor.

"Siç e dini, së bashku me MASHTI-n kemi alokuar buxhetin për ndërtimin e çerdheve të reja dhe tani ka dinamikë të shtuar dhe, për më tepër, kemi alokuar buxhet për shtimin e stafit. Vetëm për këtë vit aktual janë 243 pozita shtesë për t'i funksionalizuar

çerdhet të cilat kanë qenë të ndërtuara, por që nuk kanë qenë të funksionalizuara për mungesë të stafit" ka thënë Murati. Ndërsa ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se jo vetëm që gratë duhet të jenë të përfaqësuara

për shkak se u takon me ligj, por sepse me përfaqësimin e tyre përfitojnë ekonomia dhe shoqëria. "Ajo që ne bëjmë për përfaqësimin e grave si në treg të punës, si në shoqëri e në çdo sferë të jetës, është një ndër gjërat më krenare për punën e qeverisë. Për ne nuk është vetëm një fjalë goje, por është diçka që e praktikojmë çdo ditë në politikëbërje, në skema e në intervenimet që i kemi, mirëpo edhe në emërimet e kudo tjetër. Kjo për arsye se jo vetëm që gratë duhet të jenë të përfshira. Gratë duhet të jenë të përfaqësuara sepse kjo është e drejtë, por e njohim e kuptojmë që me përfshirjen e grave, me përfaqësimin e grave, përfitojnë ekonomia dhe shoqëria, andaj nuk është diçka që e bëjmë vetëm për gratë, por e shohim si kontribut për shoqërinë", ka thënë Rizvanolli. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti.

Azemi: Nga viti 2021 mbi 100 mijë persona e kanë lëshuar Kosovën

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka thënë se kompanitë private në vend kanë mungesë të theksuar të punëtorëve të kualifikuar. Ai ka deklaruar se ikja e të rinjve mbetet shqetësim për ta ngaqë veç prej vitit 2021 mbi 100 mijë persona e kanë lëshuar Kosovën. Sipas tij, ndonëse pronarët nuk duan të deklarohen për këtë çështjeje, mungesa ka në çdo sektor, por edhe ka rast të tilla kur kryejnë punë që nuk janë të kualifikuar. "Sipas informacioneve tona, që mund të jenë edhe zyrtare, në vitin 2021 dhe 2022 mbi 100 mijë punëtorë të sektorit privat të Kosovës e kanë lëshuar Kosovën. Çka është më e rënda, këta punëtorë janë kryesisht punëtorë të kualifikuar. Zbrazëtia e tyre në vendet e punës shkakton jashtëzakonisht humbje të mëdha, kryesisht për kompanitë private. Ne jemi çdo

ditë në terren dhe secili pronar i kompanisë i ka shqetësimet e veta sepse po u mungojnë stafi përkatës. Mungesë të punëtorëve ka në secilin sektor, megjithatë merreni me mend kur punëtorët e ndërtimtarisë hyjnë në proces të punës, edhe një punëtor i cili nuk ka asnjë kualifikim, punëtori i gastronomisë hyn në punë i cili nuk ka asnjë ditë punë praktike, megjithatë po mbulohen disi, por nuk mund ta mbulosh punëtorin e kualifikuar me një punëtor të pakualifikuar", ka thënë ai për "EO". Ndonëse ka rritje të vogël të pagave, ai ka thënë se punëtorët teknikë që kryejnë shërbime edhe në institucionet qendrore paguhen deri në 180 euro. "Ka një rritje, po themi të ndjeshme, me përjashtim të atyre punëtorëve që kryejnë shërbime për institucionet shtetërore, sepse shumë kompani private kryejnë punë për institucionet shtetërore,



lidhen marrëveshje kontraktuale, vetëm te këto kompani nuk ka lëvizje sepse Qeveria e Kosovës ende po i mban punëtorët e sektorit

privat të Kosovës me pagën 170 euro dhe këtu kemi punëtorë teknikë të cilët, po e përsëris, kryejnë shërbime edhe në zyrën e kryeministrit dhe të ministrit

të Financave që janë përgjegjës për rritjen e pagave. Këta punëtorë marrin pagë 180 euro, kurse në të tjerat shërbime kemi një ngritje, por assesi t'i plotësojë kushtet normale të jetesës", është shprehur ai. Duke folur për Ligjin për Pagën Minimale, Azemi ka thënë se qeveria nuk ka vullnet që ta zë në zbatim këtë ligj. Ai pohon se si sindikatë janë kundër pagës prej 264 eurosh, por që asnjëherë nuk janë pyetur për këtë çështje. "Për Ligjin për Pagën Minimale, kam një bindje, që vullneti jo i mirë i Qeverisë së Kosovës ka mundur ta përfundojë këtë proces. Për Ligjin e Pagave herën e parë është bërë leximi i parë në Kuvendin e Kosovës, është kthyer që Qeveria e Kosovës t'i bëjë disa përmirësime. Megjithatë, ne kemi thënë më mirë të mbetet kështu sesa të thotë e kam rritur pagën 264 euro sepse nuk po na hyn më në punë", ka deklaruar Azemi.

PKD-ja fton seancë të jashtëzakonshme, kërkohet shkarkimi i kryeshefit dhe i bordit të KEK-ut

PRISHTINË, 24 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PKD), Abelard Tahiri, ka bërë me dije se ky subjekt politik ka ftuar për të merrkurën një seancë të jashtëzakonshme lidhur me arrestimin e kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi.

Tahiri ka kërkuar të shkarkohet kryeshefi dhe bordi i KEK-ut. "Nga ora 11:00 mendojmë të fillojmë seanca. Janë 40 nënshkrime nga deputetët e opozitës. Do ta ftojme edhe kryeministrin Albin Kurti për të folur për arrestimet dhe zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në KEK. Është diçka e

paprecedentë që të mbrohet një kryetar i cili është i arrestuar dhe në paraburgim. Ai akoma nuk është shkarkuar. Duhet të shkarkohet edhe bordi i KEK-ut. Po ashtu, kemi pasur një mbrojtje ndaj këtij drejtori nga pozita dhe vetë kryeministri Albin Kurti", ka thënë Tahiri.



Strategu amerikan Elbridge Colby: Pse Kina është më e rrezikshme se Rusia



Nga Freddie SAYERS
“UnHerd”

Që nga shkrimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes për presidentit Donald Trump në vitin 2018, Elbridge Colby është bërë një nga mendimtarët konservatorë më me ndikim në SHBA në lidhje me çështjet e mbrojtjes. Nëse një republikan fiton presidencën në vitin 2024 – qoftë Trump apo DeSantis – ai ka të ngjarë të jetë sërish në qendër të pushtetit. Gjatë bisedës tonë ai foli për një fokus kretësist në ndryshim për ushtrinë amerikane: larg Ukrainës dhe drejt një konflikti me Kinën që ai beson se mund të ndodhë brenda vitit 2027.

Ju nuk jeni as plotësisht një izolacionist por as një mbështetës i një angazhimi maksimal të SHBA nëpër botë. Cili është vizioni juaj për strategjinë amerikane?

Perspektiva ime është se ekuilibri i duhur për Amerikën, por sigurisht edhe i një lëvizje politike të së djathtës së qendrës, është të pyesësh se çfarë është në interesin konkret të popullit amerikan. Nëse shihni shumicën e votuesve të Partisë Republikane, ata përbëhet nga amerikanë të klasës punëtore dhe të mesme. Unë nuk mendoj se politika jonë e jashtme u ka shërbyer atyre. Ne kemi pasur një politikë të jashtme maksimaliste që ka pasur pasoja katastrofike. Amerikanët janë realisht të lodhur nga “luftërat e përgjeshme”.

Dhe çfarë është në interesin e tyre? Le ta fillojmë duke pyetur nëse Amerika është shumë e përkushtuar në mbrojtjen e Ukrainës...

Fokusi ynë kryesor duhet të jetë Kina. Ajo është shumë më e frikshme ekonomikisht, por tani po bëhet e tillë edhe ushtarakisht. Këtë e kam theksuar edhe në strategjinë kombëtare të mbrojtjes që hartova 5

vite më parë. Aktualisht ne jemi shumë të përqendruar tek Ukraina. Unë nuk jam për ndërprerjen e ndihmës ndaj ukrainasve. Mendoj se ajo që bëri dhe po bën Rusia është shumë e keqe. Por nëse politika jonë e jashtme ka të bëjë me interesat konkrete të amerikanëve, atëherë ne po bëjmë më shumë se duhet atje. Kemi shpenzuar deri tani mbi 100 miliardë dollarë. Kemi dërguar pajisje ushtarake që nuk janë lehtësisht të zëvendësueshme, të cilat janë të rëndësishme për luftën e mundshme mbi Tajvanin. Ndaj pasojat e kësaj qasje mbi industrinë tonë të mbrojtjes janë shumë domethënëse. Kjo gjë mund të duket si e paqartë, por nuk është ashtu. Mbretëritë janë shkatërruar edhe vetëm për mungesën e këpucëve nga ushtarët. Unë pyes: Pse po rrezikojmë sfidën më të rëndësishme për pozicionin e SHBA-së në botë dhe interesin tonë për botën në 150 vitet e fundit?

Nëse do të ishit sot këshilltari kryesor i presidentit Biden, çfarë do t'i këshillonit të bënte?

Unë do t'i këshilloja: “Duhet të përqendrohemi fillimisht mbi Tajvanin, Kinën dhe Azinë, dhe pasi ta rregullojmë këtë problem në një shkallë të kënaqshme, do të shpenzojmë kohë dhe kapital politik dhe burime në Ukrainë”. Gjykoj se duhet të ushtrojmë shumë më tepër presion dhe inkurajim ndaj Evropës që ajo të marrë rolin kryesor në ndihmën ndaj Ukrainës.

Pse Shtetet e Bashkuara po ofrojnë pjesën të madhe të mbështetjes ushtarake dhe financiare për Ukrainën? Kjo nuk ka kuptim. Evropa është një zonë ekonomike shumë më e madhe se Rusia. Ajo ka avantazhe të mëdha ushtarake

përballë Rusisë. Por vendet evropiane e kanë rritur angazhimin muajt e fundit. Kështu Gjermania ka hequr dorë nga pozicioni i saj neutral i pasluftës... Me vjen keq ta them se kjo nuk është e vërtetë. Gjermanët e shpërbënë ushtrinë e tyre, jo si rezultat i Luftës së Dytë Botërore, por i fundit të historisë dhe dividentit të paqes. Ata kishin një ushtri shumë të madhe dhe mbresëlënëse kur Republika Federale kërkonte të mbrohej kundër sovjetikëve dhe Bllokut Lindor.

Kjo ka qenë një çështje politike, sidomos në kohën e ish-kancelares Merkel. Pyetja është: A mund ta rindërtojë Gjermania ushtrinë e saj? Në fakt nuk ka ndonjë shpresë për këtë. Dhe këtë vit buxheti i saj ushtarak do të jetë sërish poshtë pragut 2 për qind të PBB-së. Vendi që meriton duartrokitje në këtë aspekt është Polonia, e cila ka angazhuar gati 5 për qind të PBB.

Po Britania e Madhe?

E vlerësoj shumë ambicien e saj. Nën drejtimin e Boris Johnson, ajo u angazhua të shpenzojë 3 për qind të PBB për mbrojtjen. Por mendoj se kjo shifër ka rënë tani. Mendoj se Britania është më e angazhuar në Evropë, pikërisht sepse ne amerikanët duhet të zhvendosemi në Azi.

Por Britania e Madhe ka aftësi shumë të kufizuara për të projektuar fuqi serioze ushtarake. Nëse Kina merr nën kontroll Azinë, në një situatë hegjemonike që mendoj se është qëllimi i saj, interesat tona do të dëmtohen shumë më tepër sepse Azia është një zonë ekonomike shumë më e madhe se Evropa.

Kina është një fuqi shumë më e madhe dhe më e frikshme se Rusia. Pra, pyetja është, kush do të përballojë koston? Nëse Evropa

justifikohet duke thënë “Ne s’mund ta bëjmë, pasi do të na marrë shumë kohë”, atëherë duhet që të përballojë pasojat e këtij vendimi dhe kësaj paaftësie.

A do të thotë kjo se ka vdekur përpjekja për të mbajtur prapa linjën e frontit rus në Ukrainë apo edhe për ta shtyrë atë më në lindje? Natyrisht, gjërat mund të arrihen në të njëjtën kohë. Problemi është se në nivelin politik, ne amerikanët duhet të sigurohemi që të ndahet gjithçka që nevojitet për një luftë të mundshme mbi Tajvanin, pra burimet të shkojnë atje. Ne i dhamë Ukrainës një grup tankesh Abrams. Është shumë e vështirë të imagjinohet që këto tanke të jenë të dobishëm në një luftë me Kinën.

Edhe avionët tanë F16 dhe F35 do të hasnin probleme përballë kinezëve. Ndaj unë nuk e kuptoj pse ne nuk po u dërgojmë ukrainasve avionët F16. Por edhe rusët po hasin shumë probleme. Kjo e sotmja nuk është Ushtria e Kuqe e vitit 1945. Ju evropianët nuk duhet të pranoni asnjë triumf të saj mbi ukrainasit. Ju jeni një zonë e madhe ekonomike. Problemi është se Evropa nuk po ndryshon qasje.

Traktati i NATO-s thotë se “një sulm ndaj njërit është një sulm ndaj të gjithëve”. Nëse Rusia pushton Poloninë ose Lituaninë, ky akt duhet të trajtohet nga Amerika si një sulm ndaj vetë saj, dhe për këtë arsye do të kërkojë të gjitha aftësitë e saj mbrojtëse....

Në fakt traktati nuk thotë këtë. Dhe ne nuk do ta trajtonim një sulm ndaj një aleati evropian në të njëjtën mënyrë si një sulm ndaj vetë Shteteve të Bashkuara. E gjithë strategjia e NATO-s gjatë Luftës së Ftohtë ishte qartazi për të mos e bërë këtë. Natyrisht niveli retorik është tjetër nga ai praktik.

E mira është që rusët nuk janë mjaftueshëm kërcënues për ta ndërmarrë këtë veprim. Ata nuk mund ta kërcënojnë NATO-n evropiane, duke pasur parasysh

ngërçet që kanë pasur në Ukrainë, të paktën prej disa muajsh. Problemi ndryshon me Kinën, që është në një farë kuptimi, Bashkimi i ri Sovjetik.

Çfarë ju bën kaq të sigurt se Kina po planifikon në të vërtetë një lloj sulmi ndaj Tajvanit?

Nuk mendoj se ka shumë vend për debat. Udhëheqësi i qeverisë më të bashkuar kineze që nga koha e Maos, i ka dhënë në mënyrë eksplicite udhëzime ushtresë që të jetë gati për të sulmuar Tajvanin brenda vitit 2027. Dhe kinezët supozojnë se amerikanët do të vinin në mbrojtje të Tajvanit.

Kjo do të thoshte një luftë Kinë-SHBA. Dhe kjo nuk është vetëm një retorikë. Shihni ushtrinë që po ndërtojnë. Ajo është projektuar për të përballuar jo vetëm Tajvanin, por Shtetet e Bashkuara dhe Japoninë. Kinezët po ndërtojnë një ushtri globale që duket si ushtria amerikane: aeroplanmbajtëse, satelitë hapësinorë, nëndetëse me energji bërthamore.

Por Kina është në fakt një shtet shumë i kujdesshëm. Pse do të rrezikonte ta fuste të gjithë botën në luftë?

Nuk e di se si kinezët e kanë fituar një reputacion të tillë. Ata e fituan Luftën Civile me mjetet më brutale të mundshme. Pastaj pushtuan Tibetin, ishullin Haina, ndërhyjnë drejtpërdrejt në Luftën Koreane dhe sulmuan drejtpërdrejt Vietnamin në 1979. Pse do ta bënin tani?

Mendoj se kanë nevojë. Xi Jinping po thotë se SHBA po përpicën të asfiksojnë Kinën. Ju e shihni se çfarë po bën ai me Vladimir Putinin dhe Rusinë. Ata na konsiderojnë si një kërcënim gati ekzistencial, që gjë është shumë e rrezikshme.

Marrë me shkurtime/bota.al

Ja pse përvojat afër vdekjes janë reale dhe nuk janë ëndrra



Nga Gabriele IAGANA

A është vdekja fundi i gjithçkaje apo ka një jetë përtej jetës tokësore? Njerëzit e të gjitha moshave ia kanë bërë vetes këtë pyetje të paktën një herë gjatë ekzistencës së tyre. Për këtë nuk ka ende një përgjigje përfundimtare. Dhe ndoshta nuk do të ketë kurrë. Shkenca nuk ka siguri për atë që ndodh kur pushon së rrahuri zemra jonë.

Megjithatë në dekadat e fundit, disa studiues kanë nisur të studiojnë një fenomen që ndodh kur dikush është afër vdekjes: Near Death Experiences, NDE (Përvoja pranë vdekjes). Këto janë dukuri të përshkruara nga njerëz që kanë rifituar funksionet vitale pas një periudhe të kaluar në koma ose pasi janë shpallur klinikisht të vdekur.

Libri i mjekut dhe shkrimtarit amerikan Raymond Mudi "Jeta përtej jetës", botuar për herë të parë në vitin 1975, u bazua tek dhjetëra dëshmi mbi këto përvoja. Që atëherë, shumë mjekë të tjerë i kanë kushtuar një pjesë të kohës së tyre studimit të NDE-ve, duke dhënë kontribute interesante.

Ndër figurat më të famshme në këtë fushë, sa për të përmendur vetëm disa, spikasin Pim Van Lommel, Sam Parnia (që drejton projektin AËARE, me studimin më të gjerë të kryer ndonjëherë që

përfshin 25 spitale në mbarë botën), Brus Grejzën dhe italianin Enriko Fako.

Në një intervistë për "Il Giornale", Fako, ekspert në anesteziologji dhe reanimacion dhestudiuës në departamentin e Neuroshkencave të Universitetit të Padovës, thotë se përkundër skepticizmit të disa njerëzve këto përvoja janë reale.

A janë përvojat afër vdekjes dukuri sporadike apo ngjarje të shpeshta?

NDE-të janë ngjarje relativisht të shpeshta, të cilat ndodhin gjatë gjendjeve shëndetësore kritike që shoqërohen me humbje të vetëdijes.

A mund të na thoni përqindjen?

Në studime të ndryshme, thuhet se kjo ndodh në 5 dhe 18 për qind të rasteve tek pacientët që pësojnë arrest kardiak.

Si mund të përkufizohet një NDE?

Ato janë përvoja subjektive intensive dhe të thella me një aspekt transhental, që ndodhin në gjendje shëndetësore kritike, të shoqëruara me humbje

të vetëdijes (si arresti kardiak, trauma në kokë, gjendje shoku etj) dhe që karakterizohen nga perceptimi i qartë i të qenit në një dimension të ndryshëm nga i zakonshmi i jetës tokësore, nga braktisja e trupit fizik dhe shkuarja përtej kufijve të vetvetes dhe dimensionit hapësinor-kohor të botës së zakonshme fizike.

A mund të jenë përvojat afër vdekjes forma deliri, ndryshime organike kalimtare të trurit apo edhe anoksi?

Interpretimet shkencore të propozuara deri më tani, janë të natyrës mekaniko-reduksioniste dhe kanë hipotetizuar se ato e kanë origjinën nga çrregullimi cerebral i prodhuar nga goditja në tru. Megjithatë janë hipoteza pa ndonjë konfirmim. Madje disa prej tyre, mund të hidhen poshtë në bazë të fakteve të tjera të njohura që i bëjnë ato të pamundura.

A ka vetëm elementë të përbashkët në NDE-të apo edhe të tjera subjektive?

NDE-të janë mjaft komplekse dhe përfshijnë elemente individuale dhe elemente të përbashkëta. Aspektet themelore të përvojave janë universale dhe mund të gjenden në të gjitha kulturat. Po ashtu ka gjithashtu tregues të saj në letërsinë e të gjitha kohërave, nga Homeri te Platoni, tek Dikensi, deri

tek Libri i të Vdekurve i tibetanëve.

Krahasuar me procesin e ëndërrimit, si janë përvojat afër vdekjes?

Ëndrrat kanë një gjuhë shumë të ndryshme, që karakterizohet nga mbivendosja e shumë elementeve të ndryshme, të cilët e bëjnë të vështirë ose të pamundur kuptimin e menjëhershëm. Ato ishin objekt i një pune të gjatë interpretuese të Sigmund Frojdit.

Pse nuk raportojnë që të gjithë se kanë përjetuar një NDE?

Për dy arsye thelbësore. Së pari, jo të gjithë i përjetojnë ato. Së dyti, duke qenë përvoja të një aspekti transhental dhe me një përmasë mistike, ato vendosen jashtë asaj që pranohet në mënyrë konvencionale nga pikëpamja e sotme mbizotëruese. Ndaj ekziston një rrezik i madh që ato të keqkuptohen, dhe kushdo që i ka përjetuar të konsiderohet si vizionar apo që vuan nga një problem mendor pas insultit cerebral.

Për shembull skeptikët argumentojnë thonë se vizioni i dritës që shihet në një NDE, është në fakt ai që shihet në dhomën e spitalit. Është e mundur? Është vetëm një hipotezë pa asnjë


konfirmim. Drita e perceptuar në NDE, ka karakteristika shumë të ndryshme nga ato të dritës artificiale, dhe është vetëm një element i vetëm i një përvoje shumë më të pasur dhe më komplekse. Në rastin më të mirë mund të jetë një lloj shkas i kësaj përvoje, e cila ka një natyrë dhe implikime shumë më të gjera.

A janë NDE-të vetëm pozitive apo ka raporte për përvoja negative?

Ka përvoja negative, edhe pse në një përqindje më të vogël të rasteve. Ndonjëherë pjesa negative është një element i përvojave që përfshijnë elemente negative dhe pozitive. Në raste të tjera ajo që përjetohet është skenari pozitiv NDE, por i përjetuar në mënyrë negative. Ose një situatë që është në vetvete neutrale (p.sh të qenit në një gjendje boshllëku apo errësirë), por e përjetuar si shumë stresuese. Shumë më rrallë raportohen përvoja të skenarëve shqetësues (ka nga ata që i përkufizojnë si "djallëzore").

Kush është i prirur të ketë përvoja negative afër vdekjes?

Nuk është ende e qartë nëse dhe cilët njerëz mund të jenë në gjendje të favorizojnë përvojat negative. /



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Akis Vavalis: Dua të bëhem kampion me Dritën

Skuadra e Dritës e ka emëruar trajnerin e ri. Akis Vavalis do të jetë pasardhës i Arsim Thaqit në pozitën e shefit të shtabit teknik, ndërsa synim i strategut grek është rikthimi i titullit kampion në Gjilan



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

GJILAN, 24 PRILL - FC Drita në orët e fundit të ditës së diel e prezantoi trajnerin e ri, Akis Vavalis. Strategu nga Greqia është pritur nga drejtori gjeneral Feti Murseli, i cili i dëshiroi mirëseardhje dhe shumë suksese me klubin. Marrëveshja e nënshkruar mes klubit dhe trajnerit Vavalis është deri në fund të sezonit 2023/2024 me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. Vavalis ka përvojë dymbëdhjetëvjeçare si trajner dhe ndihmëstrajner. Vavalis i bashkohet Dritës së bashku me ndihmësin e tij, Nikolas Karabetakis.

Një ditë pasi është bërë zyrtar angazhimi i Akis Vavalis në krye të shtabit teknik në skuadrën e Dritës, të hënën teknik grek ka folur si trajner i skuadrës nga

Gjilani. Ai ka thënë se ndihet i lumtur dhe i emocionuar që është në një klub si Drita, derisa nuk ka ngurruar të tregoj se synim i tij është ta fitojë titullin e kampionit në Superligë. "Jam shumë i lumtur që jam këtu te Drita. Jam i emocionuar për një përvojë të re. Të jem këtu është kënaqësi. Synimi është të avancojmë dhe ta fitoj titullin. Kam pasur një ide dhe e kam përcjellë kampionatin gradualisht dhe jam i lumtur që jam këtu. Arsyeja kryesore pse jam unë këtu është për shkak se dua të bëhem kampion me Dritën, ne duhet të kemi rezultate, nëse nuk kemi shkojmë në shtëpi, kjo është puna e një trajneri", ka thënë Vavalis.

Ky i fundit ka treguar se i ka shikuar dhjetë ndeshjet e fundit të Dritës dhe se shprehet i lumtur që do t'i stërvitë këta futbollistë. "10 ndeshjet e

fundit të Dritës i kam shikuar. Edhe të fundit. Çdo ditë mund të shohësh gjëra negative dhe pozitive. Në këto momente jam i lumtur që do t'i stërvitë këta futbollistë. Së pari nuk dua të mendoj për pozitën e dytë. Për gjashtë ndeshje nuk mund të ndryshoj. Kam nënshkruar një kontratë që në mendjen time të jap 200 për qind nga vetja dhe stafi për ta bërë Dritën kampionë. Kemi raste. Nuk është koha e duhur ta komentojmë, por ta gjejmë një zgjedhje që ta bëjmë Dritën kampionë. Në skenarin më të keq kjo do të na motivojë për të dalë kampionë në sezonin tjetër", ka shtuar Vavalis. Drita renditet në pozitën e dytë me 60 pikë, një më pak se Ballkani që zë vendin e parë. Në ndeshjen e fundit gjilanasit shënuan fitore ndaj Prishtinës, kurse ndeshjen e radhës e zhvillojnë kundër Ferizajt.

SHKURT

Sobowale: Malisheva do të qëndrojë në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin Çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 30-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Ronald Sobowale. Sobowale ishte vendimtar në fitoren tejet të rëndësishme në garën për mbetje në elitë që FC Malisheva e realizoi si mysafir kundër Ferizajt. Ai shënoi dy gola në fitoren e skuadrës malishevase, të cilat e stabilizojnë atë në pozitën e shtatë, me 33 pikë. Pasi iu dha ky çmim, Sobowale u shpreh i lumtur për vlerësimin, derisa vuri në pah optimizmin e tij që Malisheva ta sigurojë mbetjen në elitë edhe në këtë edicion. "Jam shumë i gëzuar për këtë çmim dhe i falënderoj shumë bashkëlojtarët e mi. Mendoj që Malisheva do të qëndrojë në Albi Mall Superligë meqë gjithçka është në dorën tonë. Na duhet të punojmë shumë sepse kemi para vetës gjashtë ndeshje shumë të vështira. Përvoja ime në Kosovë është shumë e mirë dhe e shijoj çdo ditë. Njerëzit këtu janë shumë të këndshëm dhe mikpritës", ka theksuar Sobowale.

Shtyhet gjysmëfinalja e pestë në mes të Prishtinës dhe Trepçës

Ndeshja e pestë gjysmëfinale e "play-off"-it të Superligës së basketbollit në mes të Sigal Prishtinës dhe Trepçës është shtyrë për 24 orë. Në fakt, derbi i rivalëve të moçëm ishte paraparë të luhej këtë të enjte. Por, me terminin e ri, loja u shty për të premtën për shkak të punimeve që po bëhen për hendboll në sallën e Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë. Sigal Prishtina dhe Trepça aktualisht janë baras, 2-2 me ndeshje dhe finalist i dytë do të përcaktohet të premtën. Në finale tashmë është kualifikuar Peja, e cila e eliminoi Golden Eagle Yllin, të cilin e mundi 3-1 me ndeshje në gjysmëfinalen tjetër.

Rrahmani: Mbajeni mend këtë foto për gjithë jetën

Napoli arriti të fitonte në Torino vetëm në sekondat e fundit ndaj Juventusit, fitore kjo që afron edhe më shumë me titullin kampion. Kurorëzimi i napolitanëve është vetëm çështje kohe, duke qenë se kryeson me 13 pikë para Lazios kur kanë mbetur edhe shtatë javë nga fundi i kampionatit. Mbrojtësi shqiptar Amir Rrahmani mori pak sekonda në këtë takim, duke qenë se vinte nga një dëmtim në këmbë dhe ishte grumbulluar për ndeshje vetëm në minutat e fundit. Megjithatë, kjo nuk e ka zbehur entuziazmin e mbrojtësit që nëpërmjet rrjeteve sociale ka provokuar jo pak tifozët kundërshtarë. "Mbajeni mend këtë foto për gjithë jetën", shkruan Rrahmani në foton e festës pas ndeshjes. Rrahmani ka qenë protagonist këtë sezon me Napolin, duke zhvilluar ndeshje pozitive dhe me vlerësime nga specialistët e futbollit.

Kosova përgatitet për ndeshjet e kualifikimeve për 'Euro 2024'

PRISHTINË, 24 PRILL - Hendbollistët e Përfaqësueses së Kosovës tashmë kanë nisur përgatitjet për dy ndeshjet e fundit të kualifikimeve për "Euro 2024". Kjo javë i takon Përfaqësueses së Kosovës. Të enjten prej orës 20:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në

Prishtinë është ndeshja Kosova - Mali i Zi, ndërsa të dielën prej orës 18:00 është takimi Sllovenia - Kosova që luhet në Velenje. "Kemi disa mungesa të rëndësishme, ndërsa disa prej lojtarëve janë të lodhur për shkak të ndeshjeve të shumta e të shpeshta në nivel klubesh.

Por përkushtimi është maksimal për ta konfirmuar nivelin që e kemi arritur. Ndeshja me Malin e Zi nuk do të jetë e lehtë për ne, por nuk do të jetë e lehtë as për Malin e Zi", ka thënë selektori Bujar Qerimi. Të dielën mbrëma ishte stërvitja e parë e

"dardanëve", ndërsa stërvitja tjetër u zhvillua të hënën paradite. Atmosfera është shumë e mirë, ndërsa lojtarët janë të vendosur për ta shfrytëzuar maksimalisht këtë grumbullim për hapin tutje dhe ambientimin e ardhjeve të reja.



De Gea: Dimë si ta mposhtim Cityn

MANCHESTER, 24 PRILL - Manchester Unitedi ka kaluar në finalen e madhe të Kupës FA vetëm pas ekzekutimit të penalltive në gjysmëfinale ndaj Brightonit. Në përballjen me rivalin lokal Manchester City do të tentojë ta fitojë këtë trofe. Portieri David De Gea ka thënë se kanë kapacitet ta

mposhtin rivalin lokal në finalen e madhe të "Wembley". "Ishte një ndeshje e vështirë përballë Brightonit. Përballë kishim një skuadër shumë të mirë. Ishim përgatitur edhe për penalltitë dhe u mundova t'u ushtroja pak presion gjuajtësve të Brightonit. Ne nga ana tjetër ishim perfekt.

Siguroam një tjetër finale pas asaj në Kupën e Ligës, edhe pse tani duhet të përqendrohemi pak te ndeshja e kampionatit me Tottenhamin. Ka kohë për finalen dhe jam i sigurt se ndaj Cityt do të jetë një ndeshje e madhe. Ajo është një prej skuadrave më të mira në Evropë, por në këtë sezon

kemi treguar se dimë si ta mposhtim. Në këtë sezon e kemi fituar një trofe. Do të përpiqemi të marrim një tjetër dhe duhet të sigurojmë një vend mes katër më të mirave në kampionat. Sigurisht, nuk është mjaftueshëm për një klub si Unitedi, por jemi përmirësuar në krahasim me



sezonin e kaluar. Kemi ndeshje të mëdha përpara dhe duhet të jemi gati", ka thënë De Gea.

'Hirushja' e kampionatit gjerman vendos dy rekorde, gati për hapin final

BERLIN, 24 PRILL - Bundesliga është në sprintin final, teksa kanë mbetur edhe pesë javë deri në fundin e kampionatit. Gara për titull, zona evropiane dhe mbijetesa janë të hapura e gjasat janë që gjithçka të vendoset në javën e 34-t. Surpriza e këtij edicioni mban emrin Union Berlin. Skuadra nga kryeqyteti për shumë javë ishte kryesuese e Bundesligës, ndërsa tani është forcë e tretë e kampionatit, duke pretenduar pjesëmarrjen në zonën e Ligës së Kampionëve sezonin e ardhshëm. Union Berlin fitoi minimalisht në ndeshjen e javës së 29 me Borussia M'gladbachun, duke regjistruar suksesin e 16 në këtë edicion. Në këtë mënyrë, kryeqytetasi barazojnë rekordin e tyre me 16 fitore dhe e kanë mundësinë ta përmirësojnë këtë rekord në pesë ndeshjet që kanë mbetur. Nga 55



pikët që kanë marrë, 23 i kanë grumbulluar nga ndeshjet jashtë shtëpisë, shifër që nuk e kishin arritur asnjëherë më parë në të shkuarën, duke regjistruar një tjetër rekord. Union ndodhet pesë pikë larg Borussia Dortmundit,

kryesuese dhe katër pikë larg Bayernit, por një biletë për në grupet e Ligës së Kampionëve sezonin e ardhshëm do të ishte mjaftueshëm për ta finalizuar me sukses një edicion shumë të suksesshëm.

Golden State barazon serinë e çerekfinaleve, fitojnë Bostoni e New Yorku

SACRAMENTO, 24 PRILL - Kampionët e Golden States barazojnë 2-2 serinë e çerekfinaleve pas fitores me rezultat 126-125 ndaj Sacramentos. Një ndeshje e ekuilibruar dhe e hapur deri në fund, ku u dallua Stephen Curry, autor i 32 pikëve, mbështetur nga Thompsoni me 26 pikë e Poole me 22 pikë. Për Sacramenton u dallua Foxi me 38



pikë, por që mbetën për statistikë. Pas kohës shtesë ndalet Denveri, që u mund me shifrat 114-108 nga Minnesota, që mban gjallë shpresat për një vend në gjysmëfinale (Denveri udhëheq 3-1 me ndeshje). Jokiçi realizoi 43 pikë e 11 rebounde, por që s'mjaftuan për fitore, ndërsa për vendasit u dallua Edwardi me 34 pikë. Në Lindje,

ekipi i New Yorkut udhëheq 3-1 serinë pas fitores me rezultat 102-93 ndaj Clevelandit. Brunsoni me 29 pikë e Barretti me 26 bënë dallimin në fushë për nju-jorkezët. Po 3-1 udhëheq edhe Bostoni, që mposhti me rezultat 129-121 Atlantan jashtë fushës, ndeshje ku për Celticsin u dalluan Tatumi e Browni me nga 31 pikë secili.

"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE KONFERENCA E LINDJES

Philadelphia - Brooklyn	(4-0)
Boston - Atlanta	129-121 (3-1)
Cleveland - New York	93-102 (1-3)
Milwaukee - Miami	(1-2)

"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE KONFERENCA E PERËNDIMIT

Sacramento - Golden State	125-126 (2-2)
Memphis - Lakers	(1-2)
Phoenix - Clippers	(3-1)
Denver - Minnesota	108-114 (3-1)

SHKURT

Peja 03, kampione e Ligës së Parë, inkuadrohet në Superligë

Peja 03 është shpallur kampione e Ligës së Parë të Femrave. Skuadra pejane në dy ndeshjet finale ka qenë më e mirë se WBC Bashkimi. Sfidën e parë vashat pejane e fituan 55:50, kurse takimin e dytë në Therandë e fituan 47:53 (11:13, 17:10, 6:16, 13:14). Peja 03 kishte përfunduar garat e rregullta me 13 fitore e një humbje, ndërsa WBC Bashkimi 12 fitore e dy humbje.

Tirana shpallet kampione e Shqipërisë në volejboll

Volejbolistët e Tiranës u shpallën kampionë të Shqipërisë në volejboll për meshkuj pas fitores 3-2 në ndeshjen e katërt finale ndaj Partizanit. Një përballje e fortë në Sallën Olimpikë "Feti Borova" në kryeqytet, me djemtë bardheblu që treguan karakter për të reaguar pasi u ndodhën dy herë në dizavantazh. Setet ishin 25-18 për Partizanin, 25-22 për Tiranën, 26-24 për Partizanin dhe pastaj 25-21 dhe 15-5 për kampionët. Skuadra e trajnerit Arben Sako u kuptua që ishte më e fortë, duke dominuar në setin final. Seria finale e "play-off"-it ndaj të kuqeve u mbyll 3-1 me fitore për bardheblutë. Ky ishte titulli i dytë radhazi për tiranastit, që edhe vjet fituan nën drejtimin e Sakos, ndërsa në total kanë 11 trofe të kampionateve shqiptare. Festa ishte e madhe dhe plotësisht e ligjshme për kapitenin Ledion Martiro, lojtarin më të vjetër dhe njëkohësisht zëvendës trajnerin Klodian Ferhati, si dhe për të gjithë volejbolistët e tjerë dhe për tifozët në sallën "Feti Borova".

Pochettino, favorit për ta marrë drejtimin e Chelseat

Drejtimesit e Chelseat nuk kanë ndër mend ta vazhdojnë punën me trajnerin aktual Frank Lampard, i cili do të largohet në fund të sezonit. Në listën e pronarit të Chelseas, Todd Boehly tashmë është trajneri i rivalëve të përjetshëm. Sipas "The Sun", kandidati kryesor për t'u ulur në stolin e klubit londinez është Mauricio Pochettino. Ish-trajneri i Tottenhamit thuhet se u ka lënë shumë përshtypje drejtuesve të Chelseas gjatë bisedimeve. Dëshirat e para të Pochettinos janë transferimi i Harry Kanes, Christopher Nkunkut dhe Victor Osimhenit.

Kahn dhe Salihamidziq rrezikojnë të shkarkohen

Bayern Munchen është kapluar nga një krizë e madhe dhe rrezikon jashtëzakonisht shumë të mbyllë një sezon pa asnjë trofe, diçka që nuk imagjinohet nga tifozët dhe nga drejtuesit e klubit. Më 22 maj do të mblidhet këshilli administrues i klubit "bavarez" ku, sipas "Bild", pritet të merren vendime të forta. Në dyshim është pozicioni i Oliver Kahnit, por nuk është i sigurt as Hasan Salihamidziq, i përfunduar nën akuzë së fundmi për shkarkimin e Nagelsmannit dhe për një merkato joefikase.

Xavi pas fitores ndaj Atletico: Mposhtëm një ekip të madh

Barcelona fitoi me rezultat minimal derbin ndaj Atletico Madridit (1-0), duke ngritur kështu edhe më shumë murin ndaj Real Madrid dhe

fitimi i La Ligës sa vjen dhe bëhet më shumë konkret për katalanasit. Xavi ishte tepër i kënaqur për rezultatit e ndeshjes, pasi e afron ekipin

e tij drejt titullit spanjoll, me një diferencë prej 11-pikësh ndaj rivalëve të "Los Blancos". "Është një fitore shumë e rëndësishme. Ishte

kyçe për objektivin tonë. Ne mundëm një ekip të madh. Ata patën raste, por ne dominuam. Duhej ta shënonim golin e dytë që do

të na kishte dhënë qetësi mendore. Përtej individualiteteve, bëme një lojë të shkëlqyer. Jam shumë i kënaqur", ka thënë Xavi.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 10.02.2023, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor Junior për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë
Numri i pozitave: Dy (2)
Numri i referencës: AJAFP/ZKA/01-02/23

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin e Auditorës së Përgjithshme Nr. 525 të datës 20.04.2023

Prishtinë, 24.04.2023 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore



OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna Kancelarija Revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a 10.02.2023. godine za radno mesto:

I. Položaj Junior revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti
Broj pozicija: Dve (2)
Broj reference: AJAFP/ZKA/01-02/23

Konkurs se otkazuje na osnovu Odluke Generalne Revizorke br. 525 datuma 20.04.2023.

Priština, 24.04.2023 Departman za upravljanje ljudskih resursa

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mërgim Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I,II,III,IV dhe Diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Sulëjman Bardhi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Ylli Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Gzim H. Derri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

